

Prindërit duhet t'u kushtojnë vëmendje çantave të shkollës

Para nisjes së shkollës fillon kërkimi për çantat e duhura të shkollës. Disa fëmijë pëlqejnë çanta me dinosaurë ose kalushë, të tjerët me piratë ose princesha. Megjithatë, për prindërit pamja e jashtme nuk ka shumë rëndësi. Në zgjedhjen e çantave të shkollës (dhe të palestrës) duhen të mbani parasysh këto detaje:

- Zgjidhni një model të lehtë, jo shumë të madh.
- Rripat e çantës duhet të jenë të gjera, me mbushje të mirë dhe padyshim jo shumë të gjata.
- Shkoni për ngjyra sigurie me dukshmëri të lartë si portokallia ose e verdha dhe materiale reflektuese në pjesët para dhe anash (për këtë ekziston një standard në Gjermani, që njihet si DIN 58124).
- Ndihmoheni fëmijën me paketimin në ditët e para.
- Pesha e çantës së shkollës nuk duhet të jetë më tepër se 1/10 e peshës trupore të fëmijës (kjo do të thotë, nëse pesha trupore është 40 kg, atëherë pesha e çantës nuk duhet t'i kalojë 4 kg).
- Lodrat dhe artikujt e kohës së lirë nuk duhen futur në çantë.
- Shishet e pijeve duhet të jenë prej një materiali mundësisht të lehtë.
- Sigurohuni që pesha të jetë e shpërndarë në mënyrë të barabartë.
- Në çantën e palestrës duhen futur vetëm gjërat e palestrës.



Më e mira është që çantën e shkollës ta kërkoni bashkë me fëmijën tuaj. Nuk është e domosdoshme të jetë e re. Keni një llojshmëri modelesh çantash të përdorura, që janë në gjendje shumë të mirë.